



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET  
E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2021

**RREGULLORE E BRENDSHME E GRUPIT TË MONITORIMIT, PËR  
RREGULLAT E RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE ME KARAKTER PUBLIK TË  
AUTORITETIT, SI DHE MONITORIMIN E SJELLJES  
SË BURIMEVE NJERËZORE, FINANCIARE, LOGJISTIKE, GJATË PERIUDHËS  
ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND 25 PRILL 2021”**

Miratoi: **SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Skënder Vrioni**

Në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kreu 2, neni 5 dhe neni 37, ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, të Urdhrit nr. 5, datë 13.01.2021 të Kryetares së Autoritetit, Vendimit nr.9 datë 24.12.2020 të KQZ-së (Komisioni Rregullator), “Për rregullat e raportimit mbi raportimin e veprimtarive me karakter publik etj”, si dhe shkresën nr.2617 prot, datë 24.12.2020 të KQZ-së, e cila ka orientuar Institucionin tonë për caktimin e një personi kontakti, me qëllim raportimin e veprimtarive me karakter publik të këtij institucioni, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të Autoritetit para zgjedhjeve, hartohet rregullorja e brendshme e grupit të monitorimit, “Për rregullat e raportimit mbi raportimin e veprimtarive me karakter publik etj të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH).

Kjo rregullore e brendshme e Grupit të Monitorimit është hartuar,

- ✚ me qëllim që AIDSSH, të raportojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para ditës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve, për zgjedhjet për Kuvend, 25 Prill 2021,
- ✚ me qëllim përcaktimin e rregullave për raportimin e veprimtarive me karakter publik të AIDSSH-së,
- ✚ me qëllim moskryerjen e veprimtarive të ndaluara, sipas përcaktimit të kategorive në KREU II, Neni 3, të Vendimit nr.9, datë 24 dhjetor 2020 të KQZ-së,
- ✚ me qëllim që të vendoset kontrolli mbi sjelljen e punonjësve të administratës së AIDSSH në përputhje me ligjin, në këtë situatë specifike. në kushtet e zgjedhjeve për Kuvend 25 Prill 2021,
- ✚ për të siguruar zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe Vendimit nr.9, datë 24 dhjetor 2020 të KQZ-së, në drejtim të respektimit të të drejtave politike të punonjësve të administratës, e njëkohësisht edhe të kufizimeve të vendosura në to, ku ndër të tjera, ndalohet pjesëmarrja e tij në veprimtari politike gjatë orarit zyrtar, si dhe shprehja publikisht e bindjeve apo preferencave politike;
- ✚ si dhe për të siguruar vijueshmërinë normale dhe të pa ndikuar nga fushata zgjedhore, të veprimtarisë së trupës së nëpunësve civilë, në shërbim të shtetit dhe qytetarëve, në këtë institucion.

Grupi i Monitorimit, harton këtë Rregullore të Brendshme e cila përcakton objektin e veprimtarisë së tij, lidhur me vendosjen e disa rregullave të hollësishme të cilat duhet të ndiqen për raportimin e veprimtarive me karakter publik të AIDSSH-së, si dhe sjelljes së burimeve njerëzore, përdorimit të fondeve financiare dhe logjistike, gjatë periudhës zgjedhore, të cilat do të jenë edhe objekt i kontrollit të grupit *ad-hoc*, të ngritur në këtë rast.

**Objekti i veprimtarisë** së këtij grupi do të jetë raportimi pranë KQZ rast pas rasti i veprimtarive të AIDSSH-së me karakter publik, si dhe sjellja e nëpunësve civilë dhe punonjësve me kontratë gjatë fushatës elektorale, që ka të bëjë me realizimin e detyrave të tyre funksionale në shërbim të shtetit dhe qytetarëve, si dhe me zbatimin e disiplinës formale në punë.

## **Përbërja e grupit të monitorimit:**

1. Skënder Vrioni	Sekretar i Përgjithshëm	Kryetar
2. Ardita Repishti	Drejtor i DMSHEQ	Anëtare
3. Mirela Lame	Përgjegjëse, Sektori Juridik dhe Prokurimeve	Anëtare
4. Vitori Fuqi	Përgjegjëse, Sektori i Financës	Anëtare
5. Florinda Rica	Përgjegjëse, Sektori i Burimeve Njerëzore	Anëtare
6. Marjana Gorica	Përgjegjëse, Sektori i Logjistikës	Anëtare

## **Puna për realizimin me sukses të objektivit të këtij grupi do të përqendrohet në këto aspekte:**

1. Grupi i Monitorimit të evidentojë veprimtaritë publike (veprimtaritë publike janë të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin e publikut në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, sipas Vendimit nr.9 datë 24 dhjetor 2012 të KQZ-së) dhe në rast se ato nuk janë të ndaluara sic parashikohen në KREU II, Neni 3 të Vendimit nr.9 datë 24 dhjetor 2020 të KQZ-së,

2. Grupi i Monitorimit pas evidentimit të veprimtarisë me karakter publik që do të kryejë institucioni, duhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë ose aktivitetit publik, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, njëheraze dhe personi i kontaktit i caktuar me KQZ-në, të raportojë veprimtarinë përkatëse në Ndërfaqe të KQZ e cila përfaqëson faqen zyrtare të internetit në shërbim të KQZ-së.

3. Në ndërfaqe të KQZ nga Personi i Kontaktit i ndihmuar nga anëtarë të Grupit të Monitorimit hidhen të dhënat për institucionin, datën dhe orën e veprimtarisë, tematikën e veprimtarisë, nivelin më të lartë të pjesëmarrjes, të ftuarit e nderit, folësit e planifikuar dhe mediatizimin e veprimtarisë me karakter publik.

4. Në rastet kut teknikisht ndërfaqja e KQZ është në pmundësi aksesimi, atëherë mund të dërgohet raportimi përkatës nëpërmjet e-mail-it zyrtar në adresën e KQZ-së [raportime.institucione@kqz.gov.al](mailto:raportime.institucione@kqz.gov.al) ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar.

5. Momenti i aksesimit në ndërfaqe, momenti i dërgimit të e-mail-it ose momenti i mbërritjes me postë përbëjnë momentin kohor në të cilin fillojnë të ecin afatet e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për shqyrtimin e raportimit, sipas vendimit përkatës të KQZ-së.

6. Gjatë orarit zyrtar 8.00 deri 16.30, punonjësit e institucionit nuk duhet të marrin pjesë në asnjë veprimtari apo organizim politik, të tilla si mitingje apo të ndonjë natyre tjetër, për llogari të forcave të ndryshme politike, pjesëmarrëse në zgjedhje.

**7.Punonjësi i institucionit** nuk duhet të bëhet pjesë e diskutimeve politike, brenda ambienteve të institucionit, me kolegët apo qytetarët/ të mos përdorë apo mbajë postera, fletëpalosje dhe objekte me simbole të subjekteve politike në ambientet e institucionit/ të mos lejojë përdorimin

apo mbajtjen e posterave, fletëpalosjeve dhe të simboleve të subjekteve politike, nga qytetarët që kryejnë shërbime në ambientet e institucionit.

**8.** Punonjësit e institucionit, të informojë grupin e monitorimit, në rastet kur konstaton shkelje të kësaj rregulloreje.

**9.** Pas orarit zyrtar, punonjësi i administratës, nuk duhet të shprehet publikisht apo në rrjetet sociale për bindjet apo preferencat politike, gjatë organizimit të veprimtarive të ndryshme politike, nga forca të ndryshme politike.

**10.** Nga ana e Njësisë së Administrimit të Burimeve Njerëzore, duhet të shënohen në orën 8.00, të gjithë punonjësit e administratës që janë me shërbim jashtë institucionit, destinacioni, si dhe akti administrativ me të cilin është autorizuar lëvizja.

**11.** Në fund të çdo dite pune, deri në përfundim të fushatës elektorale, listë prezenca e punonjësve të administratës do të nënshkruhet nga Grupi i Monitorimit dhe do të bëhet pjesë e dokumentacionit që do të materializojë veprimtarinë e tij.

**12.** Punonjësit e administratës duhet të jenë në çdo moment të gatshëm për t'u përgjigjur në telefon, me qëllim që të mundësohet mbikëqyrja e vendndodhjes së tyre, gjatë sondazheve të realizuara nga Grupi i Monitorimit. Për këtë arsye, ata duhet të regjistrojnë numrat e telefonit, pranë njësisë së administrimit të burimeve njerëzore.

**13.** Eprorët direkt, duhet të jenë në çdo rast në dijeni të lëvizjes së stafit të tyre, në të kundërt, mos pasja dijeni për mungesa të stafit, do të konsiderohet si mospërbushje e detyrave funksionale nga ana e tyre.

**14.** Grupi i Monitorimit do të organizojë kontrole në frekuenca të shpeshta gjatë orarit zyrtar, të cilat do të materializohen në procesverbale, ku punonjësit prezent në punë, duhet të nënshkruajnë në mënyrë individuale në këto akte, të cilat më pas do të administrohen si pjesë e veprimtarisë së këtij grupi.

**15.** Grupi i Monitorimit, nëpërmjet personit të kontaktit, do të komunikojë me personin e kontaktit në KQZ dhe do të përcjellë në kohë reale orientimet e këtij institucioni, me qëllim që të monitorohet sa më objektivisht situata dhe të zgjidhen në kohë problemet që dalin gjatë procesit të monitorimit.

**16.** Grupi i Monitorimit do të ndjekë me vëmendje transmetimet në media, me qëllim që të evidentojë çdo rast të sjelljes së punonjësit të administratës në kundërshtim me ligjin.

**17.** Sekretari i Përgjithshëm që në rastin konkret është i caktuar dhe si Person Kontakti me KQZ-së, do të marrin masat e duhura dhe realizojë monitorimin e zbatimit të tyre, në mbështetje të detyrave të përcaktuara në KREUIV, Neni 7, i Vendimit nr.9, datë 24.12.2020 të KQZ-së, si dhe për të penguar keqpërdorimin dhe garantuar mospërdorimin e :

- ✚ Burimeve njerëzore të AIDSSH në funksion të veprimtarive elektorale të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore,
- ✚ Fondeve të institucioneve për periudhën 4 muaj përpara deri në datën e zgjedhjeve,
- ✚ Mjeteve dhe materialeve në inventar të institucionit. për periudhën 4 muaj përpara deri në datën e zgjedhjeve,
- ✚ Veprimtaritë për të favorizuar subjekte të caktuara zgjedhore,

**18.** Sekretari i Përgjithshëm do të publikojë të dhënat e kontaktit në faqen zyrtare përkatëse të internetit të institucionit, me qëllim administrimin e çdo denoncimi apo të përfshirjes së çdo punonjësi të AIDSSH në veprimtari politike apo në mbështetje të ndonjë subjekti zgjedhor.

**19.** Sekretari i Përgjithshëm i ndihmuar dhe nga Grupi i Monitorimit, do të marrin masat që, automjetet si dhe karburanti në përdorim të institucionit të ndalohen të përdoren për veprimtari politike të fushatës zgjedhore, të subjekteve zgjedhore etj, duke urdhëruar parkimin e tyre mbas orarit zyrtar në ambjentet e punës së AIDSSH-së.

**20.** Të gjitha rastet e konstatuara me shkelje, Grupi i Monitorimit nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm do t'i dërgojë sipas rastit në KQZ ose Prokurori.

**21.** Dispozitat e kësaj rregulloreje, janë të detyrueshme për tu zbatuar nga grupi i monitorimit, si dhe për aq sa janë të përfshirë punonjësit e institucionit, të cilët duhet të njihen me këtë rregullore, nëpërmjet njësisë së administrimit të burimeve njerëzore, me qëllim që të mundësohet zbatimi i rregullave të vendosura në të, nga ana e tyre.

**22.** Rregullorja hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Sekretari i Përgjithshëm dhe është e vlefshme për periudhën zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvend 25 Prill 2021.

**23.** Veprimi në kundërshtim me rregulloren, përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit civil apo ndërprerje të Kontratës së Punës për punonjësit me kontratë pune.

### **GRUPI I MONITORIMIT**

1. Ardita Repishti	Drejtor i DMSHEQ	Anëtare
2. Mirela Lame	Përgjegjëse, Sektori Juridik dhe Prokurimeve	Anëtare
3. Vitori Fuqi	Përgjegjëse, Sektori i Financës	Anëtare
4. Florinda Rica	Përgjegjëse, Sektori i Burimeve Njerëzore	Anëtare
5. Marjana Gorica	Përgjegjëse, Sektori i Logjistikës	Anëtare